

Petër R. Prifti: Shkrimtari duhet të jetë i pa-anshëm fund e krye, dhe jo partizan e subjektiv

nga Gjekë Marinaj

Me z. Petër R. Prifti jam njohur tash ca vjet, që kur banoja në San Diego, Kaliforni. Edhe pasi u largova nga San Diegoja dhe u vendosa në Dallas, kam mbajtur kontakt me të. Gjatë viteve kemi patur rast të bashkëpunojmë në lëmin e shtypit dhe të poezisë, dhe të njihemi gjithmonë e më mirë. Ndaj e them pa veshitësi me veten se, Petër Prifti, është njeriu më i kompletuar shpirtërisht dhe intelektualisht nga të gjithë njerëzit që kam njohur gjatë gjithë jetës sime. Miqësinë që kam me të e konsideroj si një nga më të çmuarat që kam fituar gjatë kohës sime në Amerikë.

Pyetje: Ju, z. Prifti, keni botuar shkrime edhe në fushën e historisë, sidomos librin *Socialist Albania Since 1944* (Shqipëria socialiste qysh nga viti 1944). Cilat kanë qenë kriteret tuaja në përpilimin e atij libri?

P. Prifti: Pyetje me vend, që ma kanë bërë edhe të tjerë. Veprat serioze të historisë synojnë të dokumentojnë ngjarjet në bazë të fakteve dhe të vërtetës. Nga shkrimtari, disiplina e historisë kërkon analiza të sakta të njohurive që përbëjnë lëndën e historisë dhe interpretime të drejta të fenomeneve shoqërore. Prandaj shkrimtari e ka për detyrë t'i argumentojë gjërat që diskuton me kutin e logjikës, dhe jo t'i trajtojë ato kalimthi dhe përciptazi. Gjithmonë duhet të ketë kujdes të mbarë neutralitet, të mos lejojë shijet, dëshirat personale dhe pikpamjet politike që ta influencojnë në përpilimin e një veprë historike. Me fjalë të tjera, duhet të jetë i pa-anshëm fund e krye, dhe jo partizan dhe subjektiv.


Këta ishin kriteret që kisha parasysh kur shkrova librin *Socialist Albania Since 1944*. Këto kritere si duket u ranë në sy lexuesve të librit, mbasi disa prej tyre më shkruan mua duke thënë se u kishte bërë përshtypje qëndrimi im i pa-anshëm dhe objektiv.

Pyetje: Ju keni shkruar edhe mbi gjuhësinë. Jeni bashkautor i dy librave gjuhësorë, një nga të cilët trajton gramatikën e gjuhës shqipe të njësuar letrare. Por dihet se z. Arshi Pipa doli kundër gjuhës letrare. Ai kishte këndvështrim tjetër në lidhje me rregullat e gjuhës shqipe. Çfarë pasojë pati kjo në marrëdhëniet tuaja me Pipën? A nuk rrezikoi miqësinë dhe bashkëpunimin që kishit?

P. Prifti: Në planin shoqëror unë ruaj kujtime nga më të mirat për Profesor Pipën. Ne u njohëm shpejt me njeri-tjetrin, pasi ai emigroi në Amerikë më 1958, dhe u bë më miq menjëherë. Mund të them se na afrooi një ndjenjë e përbashkët shpirtërore, e cila me kalimin e kohës u forcua nga angazhimi ynë në fushën e studimeve shqiptare. Ne mbanim korrespondencë të rregullt dhe këmbënim materiale për studime mbi Shqipërinë.

Por nga mesi i dekadës 1980, marrëdhëniet tona pësuan një të çarë, kryesisht për shkak të gjuhës letrare, por edhe për disa teza të Pipës për çështjen e Kosovës. Gjithashtu unë isha kundër polemikës që zhvillohej midis tij dhe Ismail Kadaresë.

Për çështjen e gjuhës, unë e quajta të gabuar dhe të dëmshëm qëndrimin e Prof. Pipës. Mendimet e mia në favor të gjuhës letrare dhe kundër tezës së Pipës, unë i argumentova në disa shkrime, sidomos në një broshurë që botoi Shtëpia "LILO" në Tiranë me titullin, "Gjuha letrare është organizim



Z. Peter Prifti në ceremoninë e dekorimit me Urdhërin "Naim Frashëri"

i gjallë" (1995). Duke ditur urrejtjen e Pipës për gjuhën e njësuar, duke ditur gjithashtu se ai ishte tepër i vendosur në pozitat dhe qëndrimet e tij, kishte rrezik që mospajtimimi ynë për çështjet e lart-përmendur të acarohet deri në atë shkallë sa të prishte miqësinë tonë të vjetër.

Por kjo nuk ndodhi. Pipa e vuri miqësinë tonë përpara mosmarrëveshjeve tona. Ai i qëndroi besnik asaj dhe nuk e la atë të bëhej viktimë e qëndrimeve të kundërta që mbanim ne për disa gjëra. Ai kishte respekt për mua si njeri i shkencës, dhe e kishte të qartë se në botën akademike mendimet e kundërta për çfarëdo çështje janë normale. Shkurt, ai u tregua intelektual i pjekur në marrëdhëniet tona, dhe si pasojë miqësia jonë rrojti deri ditën që ai u nda nga ne.

Pyetje: Sikundër thoni edhe në librin *Socialist Albania Since 1944*, shumë të huaj e kanë poetizuar Shqipërinë duke thënë se ajo është "Zvicra e Ballkanit," ose "Lulishtja e Evropës juglindore"; ndërsa vëzhgues të tjerë e kanë ç'poetizuar duke e cilësuar atë si "tokë e panjohur" dhe "vend misterioz". Ç'thoni ju për këto vlerësime?

P. Prifti: Sa kohë që ata shprehën me sinqeritet, të huajt kanë të drejtë të thonë për Shqipërinë atë që mendojnë, sipas botëkuptimit të tyre. Unë si shqiptar i mërguar natyrisht gëzohem kur të huajt flasin mirë për vendlindjen time. Me të vërtetë, Shqipëria ka fituar simpatinë dhe miqësinë e burrave dhe grave me influencë në shumë vende të botës, kryesisht në Amerikë, Angli, Gjermani dhe Austri. Njerëz të tillë kanë bërë punë të madhe për të zbuluar imazhin e atdheut në botë.

Kur njerëz si këta, pa asnjë interes personal, e duan Shqipërinë dhe flasin bukur për atë, a nuk u takon shqiptarëve të bëjnë gjithashtu, madje dhe më shumë? Logjika dhe vetë interesi i atdheut kërkojnë nga shqiptarët, kudo që janë, që të punojnë me zell për ta bërë Shqipërinë ashtu siç e shohin këta të huaj. Shqipëria mund të bëhet vërtet një vend modern dhe i përparuar, një Zvicër e dytë në Ballkan. Kur të bëjë një transformim të tillë, atëherë do të ndryshojnë mendjen edhe ata të huaj që e shohin Shqipërinë si një vend të largët, të mbyllur dhe misterioz.


Pyetje: Në bisedat që kemi pasur së bashku, qoftë

me telefon ose me korrespondencë, ju keni shprehur shqetësim për Kosovën. Si ndiheni tani që Kosova u lirua nga forcat ushtarake të Serbisë?

P. Prifti: Dëbimi i forcave ushtarake serbe nga trualli i Kosovës, është një fitore historike e shqiptarëve, ndonëse mbërriti me një vonesë të gjatë dhe me një çmim shumë të shtrenjtë. Për luftën heroike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe sakrificat pa fund të popullit kosovar, shpreh admirim të pakufishëm.

Por shqetësimi im për Kosovën nuk do të marrë fund, deri sa ajo të fitojë pavarësinë e plotë dhe të bëhet shtet më vete. Deri sa të vijë ajo ditë, ka plot arsye për t'u shqetësuar. Serbia do të bëjë çmos të rivendosë prangat mbi Kosovën. Serbët në Kosovë asaj i shërbejnë si një "kollonë e pestë" për të prishur programin e NATO-s dhe të Kombeve të Bashkuara. Ndërkohë ajo punon për të kthyer komunitetin ndërkombëtar kundra kosovarëve. Mendoj se ky është realiteti dhe rreziku sot për sot në Kosovë.

Sidoqoftë, shqiptarët e Kosovës e kanë në dorë të shkatërrojnë ëndrën e serbëve për ta kthyer rotën e historisë në Kosovë. Për t'ia arritur qëllimit, mendoj se duhet të largohen nga dhuna kundër serbëve dhe jevgjeve në Kosovë. Nga ana tjetër, krejt dhe partitë politike të Kosovës duhet medemos të vënë interesat kombëtare në plan të parë, domethënë të bashkëpunojnë ngushtë dhe të hartojnë një program të përbashkët, që ka për qëllim fitoren e pavarësisë dhe organizimin e shtetit



Gjekë Marinaj në shtëpinë e Peter Prifti

demokratik. Me të vërtetë, këtë punë e kanë nisur, por duhet ta vazhdojnë me bindje, me zell dhe me vendosmëri deri në fund.

Pyetje: Shtëpia juaj është një bibliotekë në vetvete. Cili nga autorët tanë ose të huaj, mban të ndezur zjarrin e dashurisë tuaj për librat?

P. Prifti: Në botën e letërsisë shqiptare, unë kam patur dhe kam respekt të madh për Ismail Kadarenë. Respekti im për të bazohet në vlerat e punës së tij të shkëlqyer, vlera këto për të cilat janë shprehur herë e pas here, me fjalë elokvente, shqiptarë dhe të huaj. Është fakt se Kadareja arriti ta vendosë letërsinë shqiptare në hartën e letërsisë botërore. Madje, më pëlqen të shtoj se kam patur fatin të njihem personalisht me autorin tonë të madh, dhe të korrespondoj me atë nga koha në kohë.

Një tjetër shkrimtar të kohës sonë që vlerësoj shumë është Naum Prifti. Në shumicën e veprave të tij, lexuesi ndeshet me probleme aktuale të shoqërisë, të cilat trajtohen me seriozitetin e duhur, me një humor të natyreshëm dhe me gjuhën idiomatike të popullit. Mbi të gjitha, gjen karaktere të skalitur me mjeshtëri, që të duken të afërmi si njerëzit e lagjes ku banon.

Sa për autorë të huaj, shkrimtarët që kam dashur fort përbëjnë një varg të gjatë. Do të përmend këtu vetëm disa emra: Tolstoi, Dostojevski, Gi de Mopasan, Çarls Dikens dhe Tenesi Williams. Veprat e tyre ju vetëm që më kanë dëfryer, por më ngritën shpirtërisht, më bënë më të kulturuar dhe ndoshta më të njerëzishëm.

Pyetje: Komuniteti shqiptar ju njeh si njeri që shquan për sinqeritet. Keni ndonjë koment mbi këtë pikë?

P. Prifti: Mendoj se pyetja që më bëni është pyetje karakteri, dhe si e tillë tepër e vështirë për t'u përgjegur në mënyrë të qartë e të plotë. Sidoqoftë, me që e kemi fjalën të sinqeritetit im, unë jam i bindur se kjo cilësi në thelb nuk është merita ime personale, por dharatë e Natyrës. Edhe sikur të doja ta ndryshoja karakterin tim, nuk besoj se do t'ia arrija, se do të më duhej të luftoja kundër natyrës sime, të trashëguar që kur u lindi. Por edhe sikur t'ia arrija një synimi të tillë, nuk do të isha i kënaqur, sepse do të ndihesha si i huaj në botën time të brendshme.

Megjithatë, nuk e shtroj këtë ide si një "ligj absolut". Po të kisha ndeshur ndonjë krizë të madhe në jetën time, nga ato që përmbysin botën e një njeriu, atëherë mund të isha formuar pak më ndryshe dhe të mos shquaja aq fort për sinqeritet. Por kjo nuk ngjau dhe si pasojë, u rrita me këtë veti të karakterit tim disi të theksuar. Dua të them, megjithatë, se e kam për nder që komuniteti shqiptar më sheh si njeri të sinqertë.

Pyetje: A mos keni patur ndonjë parim ose kritër të caktuar, në lidhje me shërbimin që i keni bërë dhe vazhdoni t'i bëni komunitetit tonë në Amerikë?

P. Prifti: Në veprimtarinë time si shkrimtar dhe aktivist shqiptar në Amerikë, unë jam udhëzuar

nga të njëjtët ideale dhe qëllime që ka çdo burrë a grua shqiptare me ndjenja kombëtare. Këto ndjenja nuk është veshitë t'i zbulosh dhe t'i përvetësoh. Ato i gjen në jetën dhe veprat e Rilindasve, i gjen në historinë, folklorin dhe letërsinë tonë.

Në punët e mia, kam synuar brenda mundësive të mia të ndriçoj diasporën tonë me njohuri të ndryshme që i përkasin botës shqiptare në përgjithësi, dhe të diasporës në veçanti. Në këtë drejtim kam mbajtur fjalime në konferenca shqiptare në Boston dhe New York, kam folur në programet radiofonike shqiptare, dhe kam botuar studime mbi historinë, shtypin dhe gjuhën tonë. Me vlerë të veçantë për mua kanë qenë rastet kur kam punuar për çështjen kombëtare krahas me bashkatdhetarë të mbrujtur me ndjenja të zjarra atdhedashurie.

Pyetje: Si e shihni të ardhmen e diasporës sonë, sidomos në raport me vendin e lindjes?

P. Prifti: Me potencialin që ka diaspora sot, veçanërisht brezat e rinj me shkollë të lartë, mund të bëhen punë të mira, punë të mëdha që s'janë parë ndonjëherë në historinë e shqiptarëve të Amerikës. Por vetëm po të mobilizohen forcat tona në shkallën e duhur, dhe për qëllime që u përgjigjen nevojave të diasporës dhe atdheut.

Nuk bën të jemi pesimistë, por nuk bën as të mbyllim sytë dhe të injorojmë realitetin. Gjendemi përballë problemeve mjaft serioze. Problem shumë i madh janë shpërçarjet politike brenda komunitetit, dhe veçanërisht në New York. Gjithashtu, pak janë ata të rinj që bëhen merak për diasporën dhe Shqipërinë. Shumica shohin vetëm interesin e tyre. Kjo është e dhimbshme, por e natyrisht në ambientin shoqëror, ekonomik dhe kulturor të Amerikës, ku njerëzit konkurojnë egërsisht për sukses material dhe për të bërë një jetë sa më komode dhe luksoze. Atëherë, duhet punuar me zell e vendosmëri, në mënyrë që rinia të angazhohet për vlera, ideale dhe qëllime më të larta, që sjellin kënaqësi shpirtërore dhe shpërblime mendore më të qëndrueshme.

Përsa i përket vendlindjes, qoftë Shqipëria, Kosova ose gjetkë, diaspora e Amerikës e ka në dorë të luajë një rol historik në formimin e së ardhmes së botës shqiptare. Me potencialin ekonomik gjithmonë në rritje, si asnjëherë në të shkuarën, ajo mund t'u japë dorë bashkatdhetarëve përtej oqeanit që të mëkëmben dhe të dalin nga pellgu i varfërisë. Duke njohur dhe zbatuar parimet e sistemit demokratik të vendit ku banojmë, diaspora mund të frymëzojë shqiptarët matanë Atlantikut të bëjnë gjithashtu. Pra, të heqin dorë nga politika ataviste që kanë ndjekur deri më sot, dhe të përqafojnë një kulturë politike të re: largpamëse, të urtë, moderne, evropiane.

Në të vërtetë, shërbimi më i madh—madje shërbimi i domosdoshëm që mund dhe duhet t'i bëjë diaspora jonë mëmëdheut në kohën tonë, është të popullarizojë idenë madhore të lidhjes së popullit shqiptar me botën e Perëndimit, pra, me Evropën e Bashkuar. Domethënë, të kthehet në vatrën që ka patur në kohën e Heroit Kombëtar—Skënderbeut. Mendoj se është rruga që dikton koha, logjika dhe rrjedhat e historisë për transformimin rrënjësor të kombit të lashtë shqiptar. Ky është një qëllim fisnik për të cilin diaspora mund të punojë me vullnet të papërkulur, duke vënë në lëvizje të gjithë potencialin e saj, e bindur se do t'ia arrijë qëllimit.